

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo	
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës	
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova	
Civil Aviation Authority of Kosovo	
Nr. i prot.	2017/200/32
Br.prot./Prot.Nr.	
Faqe:	2
Stranica/Pages	Kopje: AAC
Hyrës/ulaznafin.....	<input type="checkbox"/>
Dalës/izlazno/out.....	<input checked="" type="checkbox"/>
Brendshëm/intemal/internal.....	<input type="checkbox"/>
Datum/Date	
19/09/2017	
Prishtinë/Pristina/Pristina	

QARKORE SIGURIE E AAC-së

TEMA:	Shpërndarja e raporteve të ndodhive	
Data: 19 korrik 2017	Nr. i Qarkores: 01/2017	Për : Të gjitha entitetet dhe individët që u nënshetrohen Rregullores për Raportimin e Ndodhive

Kohëve të fundit janë vërejtur disa raste të rrjedhjes së raporteve të ndodhive në publik duke krijuar lajme të bujshme në media. Përdorimi i raporteve të ndodhive për arsyen e tjerë përveç kontributit në përmirësim të sigurisë dhe parandalimit të incidenteve dhe aksidenteve është i ndaluar sipas Rregullores 01/2009 të AAC-së. Keqpërdorimin e raporteve të ndodhive e ndalon në mënyrë specifike edhe Rregullorja 376/2014 të BE-së, që është në proces të transponimit në sistemin ligjor të Republikës së Kosovës dhe në të cilën ndër të tjera thuhet "organizatat mund ta përdorin reportin e ndodhisë vetëm për arsyen për të cilën është pranuar ai report [...]" dhe "nuk u lojhet ta bëjnë të qasshëm ose ta përdorin reportin e ndodhisë për të vënë faj ose përgjegjësi, ose për çfarëdo arsyen tjetër përveç për mirëmbajtje apo përmirësim të sigurisë së aviacionit". Për më tepër, materiali udhëzues për zbatimin e kësaj rregulloreje thekson se "ndarja e informatave të ndodhive me shtypin dhe mediat nuk lejohet me Rregulloren".

Sistemi i sigurisë së aviacionit civil është i themeluar mbi bazën e shkëmbimit të të dhënave dhe mësimeve të nxjerra nga analizimi i incidenteve dhe aksidenteve. Raportimi i ndodhive dhe përdorimi i informatave nga këto ndodhi për përmirësim të sigurisë varet ngusht nga raporti dhe niveli i besimit në mes të reportuesit dhe entitetit përgjegjës për pranimin dhe analizimin e informatave të reportuara. Për t'u krijuar besimi, kërkohet aplikim i repteve i rregullave të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së informatave nga keqpërdorimi. Në këtë kontekst, informatat e ndjeshme të sigurisë duhen mbrojtur duke garantuar konfidencialitet gjatë mbledhjes së tyre dhe duke mbrojtur burimet e informatës për të krijuar besim te personeli që vepron në kuadër të sistemit për raportim të ndodhive në aviacionin civil.

Rastet e rrjedhjes së informatave nga raportimi i ndodhive kanë dëmtuar dukshëm nivelin e besimit në mes të reportuesit dhe entiteteve përgjegjëse për pranimin dhe analizimin e informatave të reportuara dhe dekurajonë raportimin e mëtutjeshëm, duke e dëmtuar rëndë sistemin e sigurisë së aviacionit civil. Përveç kësaj, kjo krijon panik të panevojshëm dhe barrë

për publikun. Duhet theksuar se publiku informohet rregullisht me informata të përbledhura mbi nivelin e sigurisë përmes "Raportit vjetor të ndodhive të obligueshme", i cili në veçanti përban trendet dhe analizat e ndodhive të raportuara dhe është i publikuar në faqen zyrtare të AAC-së.

Nga sa u tha më lart, në mënyrë që të garantohet moscënimi i sistemit të sigurisë dhe mbajtja e vazhdueshme e nivelit të sigurisë, kërkohet nga të gjitha organizatat dhe individët që janë të përfshirë në sistemin për raportimin e obligueshëm të ndodhive të mos i nxjerrin këto raporte në media dhe shtyp ose të mos i përdorin këto raporte për asnjë qëllim tjetër përveç kontributit në përmirësim të sistemit të sigurisë së aviacionit, siç përcaktohet me Rregulloren 01/2009 të AAC-së dhe Rregulloren (BE) Nr. 376/2014.

Çdo rast i tillë konsiderohet shkelje që u nënshtronhet masave ndëshkuese në përputhshje me nenin 97 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Avacionin Civil.



Dritan Gjonbalaj
Drejtor i përgjithshëm